



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1313/3 prot.

Tiranë më 05.06.2025

V E N D I M

Nr. 16, datë 05.06.2025

PËR LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 41 dhe germës “e”, të pikës 1 të nenit 82 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1313 prot., datë 02.05.2025, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale transferuesi “BKT Pay SHA”, tek marrësi “AktifTech Teknoloji A.S.” i vendosur në Turqi.

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues “BKT Pay SHA” ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi “AktifTech Teknoloji A.S.”, i vendosur në Turqi.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit, për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

1. Shteti ku do të realizohet transferimi: Stamboll, Turqi.
2. Kategoria e subjekteve të të dhënave objekt i transferimit:
 - Klientë.
3. Kategoria e të dhënave objekt transferimi:
 - Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja): *Emri, mbiemri, shtetësia;*

- Numri personal i identifikimit: *Numri personal i identifikimit, numri i pasaportës / kartës së identitetit;*
- Adresa: *Adresa e banimit / selisë së regjistruar;*
- Të tjera: *Numri i klientit epara, adresa e postës elektronike, numri i telefonit numri i kartës i maskuar në format NNNN **** *NNN dhe data e skadencës së kartës.*

4. Frekuenca e transferimit është:

- Vazhdimisht:
 - ❖ Përditë;
 - ❖ Sa herë e nevojshme.

5. Lidhur me qëllimin i transferimit, deklarohet se: *“...Subjekti marrës ofron shërbimin e prodhimit, personalizimit dhe printimit të kartave të klientëve të BKT Pay, bazuar në informacionin që dërgohet nga kjo e fundit. Pas përfundimit të personalizimit, subjekti marrës realizon paketimin dhe shpërndarjen e kartave të printuara pranë BKT Pay... Gjithashtu, subjekti marrës kryen përpunimin e transaksioneve të realizuara me këto karta përmes terminaleve POS (fizik dhe virtual) dhe pajisjeve ATM”.*

6. Ndërkohë, në Rubrikën 7 të Formularit të Aplikimit, rrethanat lidhur me përpunimin e subjektit transferues, ka deklaruar: *“Për lëshimin e kartës dhe përpunimin e transaksioneve që lidhen me përdorimin e saj, të dhëna të caktuara personale të mbajtësit të kartës duhet të ndahen me shoqërinë e kontraktuar nga BKT Pay për të ofruar shërbimin. Kjo shoqëri është përgjegjëse për personalizimin e kartave duke përdorur të dhënat, të cilat janë thelbësore për identifikimin e mbajtësit të kartës dhe për të mundësuar funksionimin e duhur të kartës”.*

7. Në lidhje me Rubrikën 8, natyra e përpunimit dhe kohëzgjatja e tij, citohet se: *“Përpunimi i të dhënave personale është thelbësor për lëshimin dhe personalizimin e kartës, si dhe për përpunimin e sigurt të transaksioneve. Kjo përfshin mbledhjen, ruajtjen, dhe transmetimin e të dhënave të mbajtësit të kartës tek shoqëria përgjegjëse për personalizimin e kartës. Përpunimi do të kryhet vetëm për qëllimin e lëshimit të kartës, verifikimit të transaksioneve dhe parandalimit të mashtrimeve, dhe do t'i përmbahet detyrimeve përkatëse kontraktuale dhe ligjore. Kohëzgjatja e përpunimit do të kufizohet në kohën e nevojshme për të përfunduar këto veprimtari, duke siguruar funksionimin e duhur të shërbimeve që lidhen me kartën”.*

8. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Të dhënat personale do të ruhen për kohëzgjatjen e nevojshme për të përpunuar transaksionet, për të mbajtur të dhënat e llogarisë dhe për të përmbushur çdo kërkesë rregullatore ose kontraktuale. Të dhënat do të ruhen për aq kohë sa kërkohet me ligj ose për sa*

kohë është e nevojshme për të zgjidhur çdo problem që lidhet me transaksionin. Pasi të dhënat mos të jenë më të nevojshme për këto qëllime, ato do të fshihen ose anonimizohen në mënyrë të sigurt në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave për të siguruar që ato nuk mund të rindërtohen ose të rikthehen”.

Në bazë të Vendimit nr. 01, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Turqia nuk përfshihet në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit, në rastet kur mungon një vendim përshtatshmërie sipas nenit 40 të Ligjit, kontrolluesi “BKT Pay SHA” duhet të marrë autorizim paraprak nga Komisioneri, përpara kryerjes së transferimit të të dhënave personale drejt një vendi të tretë pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Për këtë qëllim, kontrolluesi përveç Formularit të Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, ka depozituar edhe një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij, për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Screenshot të aplikacionit lidhur me “Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave”;
- Marrëveshje për kartat e parapaguara për individët;
- Aplikacioni epara, Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave;
- Marrëveshja e paketës së kartës Atlas, personalizimi i softuerit, prokurimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të licencës (në shqip dhe anglisht);
- Kontratë për përpunimin e të dhënave personale;
- Formular njoftimi dhe pëlqimi për transferimin ndërkombëtar të të dhënave – Lëshimi i kartës së parapaguar.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga Kontrolluesi dhe analizimit të përmbajtjes së tyre rezulton se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 41, datë 13.06.2014 të Komisionerit “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezim_nr_42_date_22_korrik_2014.pdf
[tp://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezimi_nr_41_13062014.pdf](http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezimi_nr_41_13062014.pdf)

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi “BKT Pay SHA”, plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 41 dhe germës “e”, të pikës 1 të nenit 82 të Ligjit:

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi “*BKT Pay SHA*”, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi “*BKT Pay SHA*” lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave “*AktivTech Teknoloji A.S.*”, i vendosur në Turqi, kategorinë e të dhënave personale “*Klientë*”, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja): *Emri, mbiemri, shtetësia;*
- Numri personal i identifikimit: *Numri personal i identifikimit, numri i pasaportës / kartës së identitetit;*
- Adresa: *Adresa e banimit / selisë së regjistruar;*
- Të tjera: *Numri i klientit epara, adresa e postës elektronike, numri i telefonit numri i kartës i maskuar në format NNNN **** * NNNN dhe data e skadencës së kartës.*

Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, e cila ka të bëjë me “*...prodhimin, personalizimin dhe printimin e kartave të klientëve të BKT Pay, bazuar në informacionin që dërgohet nga kjo e fundit... Gjithashtu, subjekti marrës kryen përpunimin e transaksioneve të realizuara me këto karta përmes terminaleve POS (fizik dhe virtual) dhe pajisjeve ATM*”.

2. Të dhënat personale të lejuara për t’u transferuar (parashikuar në pikën 1), pasi të mos jenë më të nevojshme për qëllimet e sipërcituara, të fshihen ose anonimizohen në mënyrë të sigurt në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave për të siguruar që nuk mund të rindërtohen ose të rikthehen.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 05.06.2025

KOMISIONERI

Besnik Dervishi